



KOMPANIA REGJIONALE PËR MBETURINA  
"EKOREGJIONI" SH.A. – PRIZREN  
Zyra Regjionale

Adresa: Rruga "KUKSIT" nr 10  
Tel: 029-241-167  
Email: krm\_ecoregjioni@yahoo.com  
info@ekoregjioni.com

Prizren: 19.04.2023

Bazuar në kompetencat të cilat burojnë nga Statuti dhe Rregulloret e K.R.M. "Ekoregjioni" SH.a.Prizren, në bazë të Ligjit Nr.03/L-212, për Rregullimin e procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, neni 4 paragrafi.6 dhe konform vendimit të Kryeshefit Ekzekutiv të datës 19.04.2023,


SHPALLË këtë:

### KONKURS

Për 2 vendë të lirë pune (me kohë të caktuar në bazë të kontratave të komunës).

Puna Provuese 6 muaj

Vendi i punës :1 Vozitës Kategoria C dhe 1 Puntorë Fizik në Njësinë Operative Suharekë.



Detyrat dhe përgjegjësitë:

#### Vozitës Kategoria C

Sipas Urdhërësës së Punës drejton automjetin dhe kujdeset për rregullësin, higjienën dhe pastërtin e tij2) Është përgjegjës për vozitje të sigurt dhe për kryerjen me kohë, efikase dhe kualitative të shërbimeve në bartjen e mbeturinave, larjen e rrugëve etj.3) Në rastet kur e kryen terrenin e caktuar angazhohet në pika (zona), tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit-kryepunëtorit,4) Para daljes në teren merr Urdhërësën e Punës në të cilën evidencën punët e kryera, vërejtjet mbi pengesat dhe defektet në automjet, dhe të njëjtën e kthen te dispeçeri,5) Vendors (monton) letren e re të tahografit ndërsa letren paraprake e kthen te dispeçeri, brenda 12 orëve,6) Vozitësi i cili e monton letren e tahografit ka obligim që në të shënon:Emrin e tij, numrin e regjistrimit të automjetit, datën dhe kilometrazhën fillestare dhe përfundimtare,7) Është i obliguar që në automjet të ketë mjetet e nevojshme të punës (lopatat, fshisat etj.), për ekipën e punëtorëve me të cilët punon,largon(bartë) shtazët e ngordhura dhe i evidenton në urdhëresën e punës8) Në rast nevojë ndrron gomat e automjetit në teren, apo në punëtorinë e mirëmbajtjes në bashkëpunim me gomisterin,9) Është i obliguar që prishjet në automjet me kohë t'i lajmron me shkrim te udhëheqësi i drejtpërdrejt dhe në punëtorinë e mirëmbajtjes10) çdo sjellje të pandërgjegjshme apo mungesë nga procesi i punës, të punëtorëve me të cilët punon, vozitësi është i obliguar ta paraqet te udhëheqësi i drejtpërdrejt-kryepunëtorit. brenda orarit të punës,11) E njofton kryepunëtorin për kontejnerët e dëmtuar dhe sipas kërkesës së tij, bënë bartjen e tyre në punëtorinë e mirëmbajtjes për riparim,12) është i obliguar që në Deponi të mbeturinave tu përmbahet rregullave dhe obligimeve të parapara në lidhje me procesin e punës në Deponi,13) Është i obliguar që çdo here pas kthimit në autopark të paraqitet te dhënësi i karburanteve për mbushje të rezervuarit me naftë,14) Nëse automjeti me të cilin punon ndodhet në prishje apo jashtë planit momental për përdorim, është i obliguar që të drejton automjet tjetër, dhe të kryen punë tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit, nevojës së procesit të punës dhe interesit të ndërmarrjes.

#### Puntorë Fizik

- Kryen të gjitha punët fizike në mbledhjen dhe ngarkimin e mbeturinave, - zbrazen e kontenjerëve dhe pastrimin e lokacionit rreth tyre; - Sipas planit operativ dhe urdhërësës së punës bënë fshirjen-pastrimin dhe larjen e rrugëve, apo pastrimin e rrugës dhe trotuareve nga bora dhe akulli, hudhjen e kripës; -Hapjen dhe mbylljen e varrit - Bënë larjen e automjeteve - Bënë largimin e qenve dhe maceve të ngordhura dhe vendosjen e tyre në kontenjer; - Është i obliguar që të ketë sjellje korrekte ndaj qytetarëve dhe shfrytëzuse të shërbimeve; - Është përgjegjës për përdorim të kujdesshëm të kontenjerëve dhe mjeteve të punës; - Kryen edhe punë tjera sipas urdhërësës së udhëheqësit; - Për punën e kryer i përgjigjet Menaxherit të Njësisë dhe Kryepunëtorit.

#### Kriteret e përgjithshme dhe procedura e vlersimit:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit.

Të punësuarit punësohen për punë me orar të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë pune(provuese në kohë të caktuar dhe mvareshit nga performanca e të punësuarve dhe nevoja e kompanisë të njëjtëve i rregullohet mardhënja e punës).



Procesi i vlersimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe në bazë të vlersimit të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.

Kandidatët fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlersimit.

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Kopja e letërnjoftimit,
- Kopja e patent shoferit për pozitën Vozitës C
- Kopja e çertifikatës së lindjes,
- Certifikatën shëndetësore sillet (pas konfirmimit të pranimit në punë)
- Certifikata penale nga Gjykata
- Kopje e diplomës të shkollës mesme, fillore etj.(qfar posedon aplikuesi) .
- Dëshmi për përvojën e punës (trust etj/ nese posedon)
- Zarf me poziten konkruuese dhe me numrin e telefonit /email adresë(për kontakt).

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë dhe atë nga data 19.04.2023 deri më 03.05.2023, ora 16:00.

Dokumentacioni i kërkuar dorëzohet me zarf të mbyllur në protokolin e Kompanisë, (shënohet emri/ mbiemri/ pozita ne te cilen konkurron, nr.telefonit dhe email adresa) në, adresën KRM "Ekoregjioni" SH.A. Rr. Kukësit nr. 10 në Prizren-kopjet e dorzuara nuk kthehen.Kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret, do të njoftohen me telefon/email për vendin dhe kohën e testit/ intervistës.

Konkursim mundë ta gjeni të publikuar në faqen zyrtare të K.R.M. "Ekoregjioni" Sh.a.Prizren, duke klikuar në: [www.ekoregjioni.com](http://www.ekoregjioni.com).

